



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U  
PRIŠTINU/MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr. regj.37301/11

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDRAVATJE NË PRISHTINË**, Gjyqtarja Lindita Jakupime pjesmarrjen e sekretarete juridike Iqrame Aliu, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Fatos Shinasi Berisha nga Prishtina, për kundërvajtje nga nen 6 par 2 te ndeshkuar me nenin 16 paragrafi 1 pika 1.1 te Ligjit për Deklarimin e Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise dhe të Dhuratave të Zyrtareve të lartë Publik Nr. 03/L-151, e në bazë të nenit 73,74,195 dhe nenit 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 29.12.2011 merr këtë:

**A K T V E N D I M**

**I PANDEHURI:** Fatos Shinasi Berisha, i lindur më 06.10.1966 në Prishtine, tani jeton në lagjen Ulpiana U 1 Hy. 5 nr.19, i martuar baba i një fëmije, Regjisori. Drejtor në Qendren Kinematografike të Kosoves, i gjendjes mesme ekonomike.

**Ë shtë përgjegjës**

Sepse si Drejtor në Qendren Kinematografike të Kosoves, nuk e ka bërë deklarimin e rregullt vjetor të pasurise deri në afatin e fundit ligjor 31 mars 2011, në Agjencionin kundër korrupcionit, sipas Ligjit 03/L-151 për Deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurise dhe dhuratave të Zyrtareve të Larte Publik.

Me kete mos veprim, ka kryer kundërvajtje nga nen 6 par. 2 të ndeshkuar me nenin 16 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin e Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise dhe të Dhuratave të Zyrtareve të lartë Publik Nr. 03/L-151, andaj

**G J O B I T E T**

**Me gjobë në shumën prej 500 (pesqindë) €, të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës kur ky aktvendim të merrë formë të prerë, në llogarine e të hyrave gjyqore KGJK-se nr. 100-4300-700-0518. Pagesa bëhet në ndonjeren agjenci-Banke për mbledhjen e të hyrave, përmes urdherpagesës së plotesuar nga Gjykata. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjtë do ti zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 33 ditësh, duke llogaritur 15 (pesëmbëdhjetë) €, për një ditë burgimi. Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqor i pandehuri është i obliguar që të paguaj shumën prej 5 € në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën. Nga një kopje e këtij aktvendimi t'i dorzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkësës.**

**A r s y e t i m**

**Agjencioni Kunder Korrupcionit në Prishtinë**, parashtroj kërkësën nr. 01 4103/10 të dt. 24.10.2011, për fillimin e procedures kundervajtëse ndaj Fatos Berishes, për kundervajtjen nga nen 6 paragrafi 2 të Deklarimin e Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise dhe te Dhuratave te Zyrtareve te larte Publik, duke kërkuar që i njëjti të shpallet përgjegjes dhe të dënoshet sipas ligjit. Gjyqatra filloj proceduren kundervajtëse me marrjen ne pyjetje te pandehurit i cili ne mbrojtjen e vet deklaroi se ka pasur shume angazhimive ne pune dhe per kete shkak ka harruar ta kryej kete obligim, pasi eshte hera e pare që kryen pune në Institucionet shtetore të Kosovës dhe përkushtuar të jep kontributin e tij maksimal. Gjithashtu ka deklaruar se nuk ka ndonjë asistent në pune i cili do ti ndihmonte. Ka këkuar nga Gjykata ti merr parasysh të gjitha rrëthanat letësuese dhe prenton se herave tejera do te jete shumë me i kujdeshem, duke shtuar se është i perkushtuar ti respektoj obligimet e dala nga Institucionet e Kosoves. Në bazë të të dhënave të parashtruarë në kërkësë, ndëgjimit të të pandehurit, shiqimit të shkresave të lëndës dhe provave të tjera të administruara gjatë procedurës, gjyqtari në masë të mjaftuar vërtetoi se i pandehuri e

03-2246/2012/02 *Re*

merr parasysh të gjitha rrethanat jetësuese dhe premton se herave tejera do te jetë shumë me i kujdeshem, duke shtuar se është i perkushtuar ti respektoj obligimet e dala nga Institucinet e Kosoves.

Në bazë të dhënavë të parashtuara në kërkesë, ndëgjimit të pandehurit, shiqimit të shkresave të lëndës dhe provave të tjera të administruara gjatë procedurës, gjyqtari në masë të mjaftuar vërtetoi se i pandehuri e ka kryer kundërvajtjen e cila me kërkesë i vihet në barrë, për çka e shpalli fajtor dhe e gjobiti me gjobën e cekur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me rastin e shqiptimi të denimit, gjyqtari vlerësoi të gjitha rrethanat nga neni 7 të LMK-së, nën të cilat është kryer kundërvajtja dhe të pandehurit ia shqiptoi këtë lloj denimi, duke llogaritur se edhe me këtë do të arrihet efekti i sanksionimit, që i pandehuri në të ardhmen t'i shmanget kryerjes së veprave të këtilla dhe të ngjashme.

Me sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:**Kundër këtij aktvendimi mund të parashtronë ankesë i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditësh pas marrjes së këtij aktvendimi, nëpërmes kësaj Gjykate dhe pa taksa.

